

interesit. Menaxhimi i rrezikut të shoqërisë fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe synon të minimizojë efektet potenciale të kundërta mbi performancën e biznesit të shoqërisë. Menaxhimi i rrezikut kryhet nga drejtimi, por nuk ka politika të aprovuara dhe procedura që mbulojnë gjithë menaxhimin e rrezikut si dhe çështje specifike, si rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normës së interesit, rreziku i kreditit, etj.

25. Angazhimet dhe detyrimet e kushtezuara

Me date 31 Dhjetor 2020, Shoqëria ka detyrime për hua afatgjate ndaj Credins Bank, sipas kontratave të kredise të komentuar në shenimin nr.8 , vlerat e të cilave janë raportuar në shenimin nr.8 dhe 12 të ketyre pasqyrave. Shoqëria dhe Banka kanë nënshkruar marrëveshjen Siguruese për garantimin e kthimit të kredise.

Shoqëria ka vendosur hipoteke mbi pasuritë e paluajtshme individuale, të paleve të lidhura me shoqërinë por edhe të treteve, si dhe 100% të të drejtat mbi shoqërinë Info Metal Plast sh.p.k. dhe Skatine-HEC sh.p.k. si dhe kontratën e koncensionit mbi sendin e ardhshëm.

26. Vijimesia e aktivitetit

Përgatitja e pasqyrave financiare është bazuar në kërkesat e SKK-ve për pasqyrat individuale të shoqërive. Drejtimi gjykon që si rezultat i rritjes së të ardhurave të realizuara nga shitja e energjisë për periudhën Janar-Prill 2021, të cilat janë +25%, krahasuar me të ardhurat vjetore të vitit 2020, por edhe planifikimi për pjesën e mbetur të vitit 2021, Shoqëria ka përmbushur kriteret që të vazhdojë aktivitetin e saj në vijimësi.

27. Rreziku nga Taksimi

Legjislacioni tatimor shqiptar është subjekt i interpretimeve të ndryshme dhe ndryshime që ndodhin shpesh. Si rezultat, transaksionet mund të rivleresohen nga organet tatimore dhe Shoqëria mund të duhet të paguaj taksa shtesë, gjopa dhe interesa, të cilat mund të jenë të rëndësishme. Periudhat mbeten të hapura për të shqyrtuar nga organet tatimore dhe doganore në lidhje me detyrimet tatimore për pesë vjet. Menaxhimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të asnjë rrethanë, të cilat mund të sjellin një detyrim të mundshëm lidhur me këtë çështje.

28. Ngjarjet pas dates së bilancit

Deri në datën e mbylljes së pasqyrave financiare me date 30 Prill 2021, nuk ka patur ngjarje të cilat të ndikonin në gjendjet e deklaruara nga shoqëria me date 31.12.2020 dhe në shenimet shpjeguese të përfshira këtu.

Ekonomist

Blerita Istrefi

Administrator

Rita Istrefi

